

RAPORTI I PERFORMANCËS

“DËSHMITARËT E JEHOVAIT NË SHQIPËRI”

Për vitin 2021

Objektivat dhe aktivitetet

Organizata jonë fetare dhe jofitimprurëse Dëshmitarët e Jehovahit në Shqipëri, është miratuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me urdhrin Nr. 100, datë 22 maj 1992 dhe është regjistruar si person juridik nga Gjykata e Rrethit të Tiranës me vendimin nr. 6087, datë 13 gusht 1993.

Organizata është krejtësisht asnjënjë në çështjet politike dhe kryen aktivitetin e saj të edukimit fetar biblik në mbështetje të vlerave më të larta morale të familjes dhe të shoqërisë.

Arritjet dhe performanca

Në përputhje me organizimin mbarëbotëror të Dëshmitarëve të Jehovahit, të vendosur për shkak të pandemisë, edhe këtu në Shqipëri të gjitha aktivitetet tona fetare kanë vazhduar të zhvillohen *online* përmes aplikacioneve që mundësojnë pjesëmarrjen njëkohësisht e një numri të madh njerëzish. Një nismë e tillë ka rezultuar shumë praktike për të mbajtur mbledhjet tona në mënyrë të sigurt, për veprën tonë të mësimdhënies biblike dhe për të ofruar ndihmë emocionale dhe shpirtërore aq të nevojshme në këto kohë.

Kemi qëndruar vazhdimisht të përditësuar me normat dhe protokollet përkatëse të institucioneve shtetërore për kufizimin e përhapjes së virusit dhe kemi ndjekur me rigorozitet të gjitha direktivat e dhëna për këtë qëllim. Organizata jonë i kushton shumë rëndësi bindjes ndaj autoriteteve shtetërore, mbrojtjes së shëndetit dhe respektit për jetën. Në vijim, ka disa të dhëna për aktivitetin tonë të zhvilluar *online* gjatë vitit 2021:

- Dëshmitarë të Jehovahit në Shqipëri, kanë kryer vullnetarisht, falas dhe sipas rrethanave personale, aktivitetin e predikimit dhe të edukimit biblik.
- Kemi organizuar mbledhje të rregullta javore dhe arsimim biblik falas me anë të mjeteve elektronike, në kongregacione dhe grupe anëmbanë Shqipërisë.
- Programet e dy asambleve njëditore janë transmetuar *online*, pasi janë regjistruar paraprakisht. Gjatë muajve korrik dhe gusht, në sitin tonë zyrtar jw.org u transmetua edhe në shqip programi i regjistruar paraprakisht i kongresit tonë treditör. Ky program u transmetua online dhe njëkohësisht në mbarë botën.
- Në mbledhjen më të rëndësishme të vitit, Përkujtimin e vdekjes së Jezu Krishtit, që u mbajt në Shqipëri më datë 27 mars 2021, morën pjesë online 15,626 veta.
- Në nëntor 2021, kemi organizuar një fushatë ndërkombëtare, përfshirë edhe Shqipërinë, me një numër special të revistës *Kulla e Rojës*, Nr. 2 2021, me titull «Në prag të një bote më të mirë». Në respektim të masave të sigurisë për mbrojtje nga pandemia, ky botim, iu është dërguar personave të interesuar në rrugë elektronike ose përmes postës.

Aktiviteti i programuar për vitin 2022

Gjatë vitit 2022, kemi planifikuar vazhdimin e aktivitetit tonë sipas modelit që kemi ndjekur gjatë vitit 2021, për aq kohë sa të vazhdojnë kufizimet e imponuara nga pandemia COVID-19. Është planifikuar mbajtja e asambleve njëditore dhe e një kongresi treditör. Po ashtu, si çdo vit do të mbahet mbledhja më e rëndësishme për ne, Përkujtimi i Vdekjes së Jezu Krishtit. Aktiviteti ynë fetar lidhur me mbledhjet javore dhe mësimin biblik në zonat e ndryshme të Shqipërisë do të vazhdojë të zhvillohet në respektim të masave kundër përhapjes së virusit.

Raportimi financiar

Për të gjitha aktivitetet e sipërpërmendura është siguruar mbështetja financiare nga kontributet vullnetare të Dëshmitarëve të Jehovait në Shqipëri si dhe nga mbështetja e vazhdueshme e vëllezërve tanë Dëshmitarët e Jehovait nga vende të ndryshme të botës; ashtu sikurse edhe organizata jonë mbështet organizatën *Dëshmitarët e Jehovait në Kosovë*.

Raporti financiar është bashkëngjitur më mposhtë.

Struktura, drejtimi dhe raportimi

Njësia Jo Fitimprurëse: *DËSHMITARET E JEHOVAIT NË SHQIPËRI*

NIPT-i: J62013012P

Adresa e Selisë: Autostrada TR-DR Km 1, Mëzez, Tiranë
Kutia postare 118 Tiranë

Veprimtaria Kryesore: Organizatë Jo Fitimprurëse Fetare (OJF)

Bordi i Organizatës “Dëshmitarët e Jehovait në Shqipëri”:

Bordi drejtues përbëhet nga 5 anëtarë përfshirë Presidentin dhe dy zëvendëspresidentët.

Njesia Jo Fitimprurese

NIPT -i

Adresa e Selise

Nr. i Vendimit te Gjykates

Data e Vendimit te Gjykates

Veprimtaria Kryesore

DËSHMITARET E JEHOVAIT NE SHQIPËRI

J62013012P

Autostrada TR-DR Km 1, Mezez, Tiranë

Kutia postare 118 Tirane

6087

8/13/1993

Organizate Jo Fitimprurese Fetare (OJF)

PASQYRAT FINANCIARE

(Organizatat Jo Fitimprurese)

(Ne zbatim te Standardit Kombetar te Kontabilitetit per OJF-te)

Viti 2021

Pasqyra Financiare jane te shprehura ne
Pasqyra Financiare jane te rumbullakosura ne

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare

Lekë

Lekë


Nga

1/1/2021

Deri

12/31/2021

3/14/2022



Dëshmitarët e Jehovahit në Shqipëri

Pasqyra e pozicionit financiar

31-Dec-21

	2021	2020
AKTIVET		
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	28,558,385	24,421,787
Të drejta dhe interesi i arkëtueshëm		
Kontribute të arkëtueshme	239,254	239,979
Inventarë dhe shpenzime të parapaguara	221,358	216,500
Investime financiare afat gjata		
Aktive të kufizuara për investime në toka, ndërtesa dhe pajisje		
Toka, ndërtesa dhe pajisje	412,114,571	422,259,970
Investime të tjera afat gjata		
Totali i aktiveve	441,133,568	447,138,236
DETYRIMET		
Të pagueshme	28,997,032	25,357,157
Dëftesa të pagueshme		
Kontribute të marra në avancë		
Donacione Grante		
Premtime të kushtëzuara për të dhënë		
Depozita ose Hua pa Interes	1,469,407	703,107
Totali i detyrimeve	30,466,439	26,060,264
AKTIVET NETO		
Të kufizuara	-	-
a) Tokë ose vepra arti të dhuruara për t'u përdorur për qëllime specifike me përcaktimin që të ruhen apo të mos shiten		
b) Aktive të dhuruara me qëllimin për t'u investuar dhe siguruar prej tyre burime të përhershme të ardhurash		
Të pakufizuara	410,667,129	421,077,972
Totali i aktiveve neto	410,667,129	421,077,972
Totali i Detyrimeve dhe Aktiveve Neto	441,133,568	447,138,236

Arben Vasili
Markus Mundi

SHOQATA
DËSHMITARËT
E JEHOVAIT
SHQIPËRI

Dëshmitarët e Jehovahit në Shqipëri

Pasqyra e aktivitetëve (performancës)

31-Dec-21

(Shpenzimet të paraqitura sipas funksionit)

Përshkrimi i zërit	2021	2020
Ndryshimi në aktivet neto të pakufizuara:		
Të ardhurat:		
Të ardhura nga tarifat e anëtarësimit		
Donacione vullnetare nga vendi	23,234,850	14,817,312
Donacione nga Shoqatat bashkëpunuese nga jashtë vendit	172,380,579	242,010,947
Të ardhura nga investimet apo dhurimet		
Tarifat për shërbimet		
Të ardhura nga aktivitetet tregtare		
Donacione Jo Monetare	10,051,748	18,554,064
Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara	205,667,176	275,382,323
Aktive neto të çliruara nga kufizimet:		
Realizimi i kufizimeve të programit		
Realizimi i kufizimit për blerjen e pajisjeve		
Përfundimi i kufizimit të afatit		
Totali i aktiveve neto të çliruara nga kufizimet		
Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara:	-	-
Shpenzime për aktivitetet		
Shpenzime për mbështetje për veprën e edukimit fetar	118,399,896	120,519,070
Shpenzime administrative, kurse stërvitore dhe kongrese	19,934,959	27,394,664
Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme	25,022,515	21,550,747
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	52,720,649	55,346,149
Krijim dhe rritje fondesh		
Totali i shpenzimeve	216,078,019	224,810,630
Rritja/rënia në aktivet neto të pakufizuara (A)	- 10,410,843	50,571,693
Ndryshimi në aktivet neto të kufizuara:		
Kontributet		
Të ardhurat nga investimet afat gjata		
Fitimi i realizuar dhe i përealizuar nga investimet afatgjata		
Humbja aktuariale nga obligacioni vjetor		
Aktivitet neto të çliruara nga kufizimet (me shenjë minus)		
Rritja/rënia në aktivet neto përkohësisht të kufizuara (B)	-	-
Ndryshimi në aktivet neto (A + B)	- 10,410,843	50,571,693
Aktive neto në fillim të vitit	421,077,972	370,506,279
Aktive neto në fund të vitit	410,667,129	421,077,972

Arben Vesili
Marius Mando

SHOQATA
DËSHMITARËT
E JEHOVAIT
SHQIPËRI

Dëshmitarët e Jehovahit Në Shqipëri

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare

31-Dec-21

Metoda indirekte

Nr	Pershkrimi i zerave	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhesë
	AKTIVITETET E SHFRYTËZIMIT		
	Ndryshimet në aktivet neto	- 10,410,843.00	50,571,693.00
	Rregullimet për përputhjen e ndryshimeve në aktivet neto me flukset neto nga aktivitetet e shfrytëzimit:	766,300.00	- 139,415.00
	Amortizimi dhe zhvlerësimi		
	Humbjet e realizuara dhe të perealizuara në investime		
	Humbjet nga dalja jashtë përdorimit e makineri pajisjeve		
	Kontributet jo në para		
	Rritjet / Rëniet jo në para të inventarëve		
	Kontributet e kufizuara për investime në dhurime / ndihma	766,300.00	- 182,644.40
	Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet afatshkurtra:	3,635,742.00	2,583,522.00
	Të tjera të arkëtueshme	725.00	371,957.00
	Shpenzime të parapaguara	- 4,858.00	- 216,500.00
	Bamirësi në mirëbesim të arkëtueshme		
	Të pagueshme	3,639,875.00	2,428,065.00
	Bamirësi mbi baza vjetore		
	Flukse neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	- 6,008,801.00	53,015,800.00
	AKTIVITETET INVESTUESE		
	Blerje / Shitje investimesh		
	Amortizimi dhe Blerje / Shitje e Aktiveve afatgjata	10,145,399.00	- 36,717,767.00
	Principal i arkëtuar nga dëftesat e arkëtueshme		
	Të arkëtuara në avancë nga dëftesa të arkëtueshme		
	Flukse neto nga aktivitetet investuese	10,145,399.00	- 36,717,767.00
	AKTIVITETET FINANCUESE		
	Arkëtime nga kontributet e kufizuara për investime në dhurime / ndihma		
	Principal i paguar për dëftesat e pagueshme		
	Flukse neto nga aktivitetet financuese	-	-
	Rritje / Rënie neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre	4,136,598.00	16,298,033.00
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës	24,421,787.00	8,123,754.00
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të periudhës	28,558,385.00	24,421,787.00
	Mjete monetare të paguara gjatë periudhës për interesa		
	Mjete monetare të paguara gjatë periudhës për tatim taksë		

Arben Vasiliqi
 Maribus Muriqi
 Dëshmitarët e Jehovahit
 SHQIPËRI

Të përgjithshme:

DËSHMITARËT E JEHOVAIT NE SHQIPËRI është një shoqatë fetare e regjistruar në formën e O.J.F-së ne Gjykatën e Rrethit Tirane me Vendimin Nr 6087 datë 13.08.1993. Ajo është e regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore, Tiranë, me NIPT J62013012P.

Shoqata është krejtësisht asnjë në çështjet politike dhe nuk kryen asnjë aktivitet ekonomik, qoftë edhe jofitimprurës. Veprimtaria e saj bazohet në ligjet në fuqi, në parimet e besimit të vetë shoqatës dhe në statutin e programin e saj. Përfaqësuesi ligjor i shoqatës është Presidenti i saj. Në mospraninë e Presidentit, ose në rastin e pamundësisë së tij për të vepruar, një nga Zëvendëspresidentët kryen të gjitha detyrat e Presidentit.

Objekt i veprimtarisë përfshin “veprën e predikimit dhe të edukimit fetar biblik në mbështetje të vlerave më të larta morale të familjes dhe të shoqërisë.”

Vullnetarët:

Shoqata jonë nuk është punëdhënëse dhe nuk ka të punësuar. Sipas statutit të Shoqatës, Komiteti Drejtues dhe çdo Dëshmitar i Jehovahit tjetër që emërohet për një shërbim të veçantë në kohë të plotë lidhur me veprimtarinë e Shoqatës, është vullnetar që vepron pa rrogë. Angazhimi i vullnetarëve tanë fetarë në shoqatën tonë nuk ka asnjë qëllim përfitimi, ata veprojnë falas, pa rrogë, si shprehje të besimit dhe bindjes së tyre. Për të gjithë vullnetarët në kohë të plotë, Shoqata ka të drejtë t’u sigurojë falas strehimin, mjetet e jetesës dhe mbështetjen financiare të nevojshme.

Politikat kryesore kontabile

Bazat e përgatitjes

Deklarimet financiare të bashkëngjitura janë përgatitur në bazë të regjistrimeve kontabël të mbajtura për qëllime të kontabilitetit të vendit në përputhje me Ligjin 9228 datë 29 Prill 2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Pasqyrat Financiare të fund vitit janë paraqitur në formatin e paraqitur në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në fuqi (SKK 2).

Përgatitja e pasqyrave Financiare në përputhje me kërkesat e SKK, kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kontabël të rëndësishme. Fushat të cilat kërkojnë një shkallë të lartë ose komplekse të gjykitimit ose ato për të cilat vlerësimet apo supozimet janë të rëndësishme për hartimin e pasqyrave financiare paraqiten në shënime.

Sipas parimeve të kontabilitetit në Shqipëri deklarimet financiare janë përgatitur mbi bazën e konceptit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Si shoqatë nuk kemi qëllim krijimin dhe përdorimin e fitimit. Veprimtaria jonë ngushtësisht fetare zhvillohet në bazë të ligjit mbi organizatat jofitimprurëse.

Shpenzimet e kryera gjatë një periudhe raportuese, janë në funksion të qëllimit të Shoqatës. Fondet e papërdorura kalojnë për llogari të vitit të ardhshëm.

Mbajtja e kontabilitetit, i cili përfshin si regjistrimet kontabël dhe sistemin e tij, mbahen në mënyrë të kompjuterizuar, me anë të një programi të kontabilitetit.

Deklarimet financiare janë shprehur në Lekë, e cila është monedha shqiptare.

Një përmbledhje të pjesës më të madhe të politikave kontabël mbi bazën e të cilave janë përgatitur deklarimet financiare janë paraqitur sa më poshtë:

Aktivitet

Mjetet Monetare përfshijnë mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse.

Në Pasqyra e pozicionit financiar përfshihen Toka dhe ndërtesa, impiante dhe makineri, të tjera. Instalime dhe pajisje që paraqiten me kosto e amortizuar minus ndonjë zhvlerësimi të mundshëm si dhe parapagime për aktive materiale dhe në proces që paraqiten me vlera nominale e shumës së parapaguar.

Detyrime, Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit, Dëftesa të pagueshme,

Transaksionet me monedhat e huaja:

(a) Monedha e përdorur dhe raportuese

Zërat e përfshirë në pasqyrën financiare maten në monedhën bazë të mjedisit ekonomik në të cilën shoqata vepron (monedha në përdorim). Pasqyrat e konsoliduara financiare raportohen në LEKË shqiptar (ALL), e cila është monedha e përdorur dhe raportuese e Organizatës.

(b) Transaksionet dhe Gjendjet

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën e përdorur duke përdorur kurset e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve në monedhë të huaj dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve në monedhë të huaj me kursin e këmbimit të fund-vitit njihen në Pasqyra e aktiviteteve (performancës)

3. Aktivitet

Mjetet Monetare

Arka dhe të ngjashme përfshijnë paratë në dorë, depozita rrjedhëse në banka.

Mjete monetare me 31/12/2021		Shuma	Vlera në Lekë
Raiffeisen ALL	1	3,411,236.00	3,411,236
Raiffeisen EUR	120.76	183,404.19	22,147,890
Raiffeisen USD	106.54	44.87	4,780
BKT ALL	1	115,913.00	115,913
BKT EUR	120.76	1728.35	208,716
BKT USD	106.54	704.37	75,044
Arka ALL	1	1,721,149.00	1,721,149
Arka EUR	120.76	4,031.22	486,810
Arka USD	106.54	3,631.00	386,847
		Totali	28,558,385
Kontribute të arkëtueshme			239,254
Inventarë dhe shpenzime të parapaguara			221,358
Totali			29,018,997

4. **Aktive** Përfaqëson Aktive me datë 31.12.2021.

	<u>31 Dhjetor 2021</u>	<u>31 Dhjetor 2020</u>
Toka	81,352,630	81,438,531
Ndërtesa	311,555,539	320,443,371
Makineri & Pajisje	17,719,277	18,610,538
Kompjuter & Programe	1,487,125	1,767,530
Totali	412,114,571	422,259,970

5. **Detyrime**

Përfaqëson detyrime për t'u paguar pas datës 31.12.2021.

Detyrime të pagueshme

Detyrimet për tu paguar dhe të tjera detyrime paraqiten me vlerën e drejtë të tyre dhe më pas maten me vlerën e tyre të amortizueshme.

5.1 *Të pagueshme*

	<u>31 Dhjetor 2021</u>	<u>31 Dhjetor 2020</u>
Llogari të tjera	464,314	563,239
Dhurata / ndihma ndaj vullnetarëve	28,392,888	24,793,918
Detyrime të tjera	139,830	
Totali	28,997,032	25,357,157

5.2 *Depozita ose Hua pa Interes përfshijnë shuma në para(ose aktive të tjera) të marra në avancë për të cilat ekziston detyrimi i kthimit.*

	<u>31 Dhjetor 2021</u>	<u>31 Dhjetor 2020</u>
Depozita pa Interes	1,469,407	703,106
Totali	1,469,407	703,106

6. **Të ardhurat**

	<u>31 Dhjetor 2021</u>	<u>31 Dhjetor 2020</u>
Donacione vullnetare nga vendi	23,234,850	14,817,312
Donacione nga Shoqatat bashkëpunuese nga jashtë vendit	172,380,579	242,010,947
Donacione Jo Monetare	10,051,748	18,554,064
Totali	205,667,176	275,382,323

7. Shpenzime të tjera

Shpenzimet janë njohur mbi bazën e të drejtave të konstatuara.
Shpenzime të tjera nga veprimtaritë

	<u>31 Dhjetor 2021</u>	<u>31 Dhjetor 2020</u>
Shpenzime për mbështetje për veprën e edukimit fetar	(118,399,896)	(120,519,070)
Shpenzime administrative, kurse stërvitore dhe kongrese	(19,934,959)	(27,394,664)
Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme	(25,022,515)	(21,550,747)
Shpenzime konsumi dhe Amortizim	(52,720,649)	(55,346,149)
Totali	<u>(216,078,019)</u>	<u>(224,810,630)</u>

Arben Vasili
Markus Münch
Dëshmitarët e Jehovait në Shqipëri

